Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0640

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga U.D Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Batisha Ibrahimi-Kryesuese, Isa Hasani dhe Vedat Poterqoi-Anëtar të Panelit Shqyrtues duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) SKYFTERAT - LIVE SH.P.K., kundër Vendimin për anulimin e procedurës së prokurimit të KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit Sigurimi Fizik i objekteve të KPSH-së me numër të prokurimit 622-26-4204-2-1-1, me 20/10/2026, mori:

Vendim

1. Aprovohet si pjeserishtë e ankesa e OE SKYFTERAT - LIVE SH.P.K. me nr. 2026/0640, e datës 25/08/2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit Sigurimi Fizik i objekteve të KPSH-së me numër të prokurimit 622-26-4204-2-1-1.

2. Mbetet në fuqi B10 Njoftimi për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit AK të KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT, aktiviteti i prokurimit Sigurimi Fizik i objekteve të KPSH-së, me numër të prokurimit 622-26-4204-2-1-1

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik SKYFTERAT - LIVE SH.P.K.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 03.06.2026 SKYFTERAT - LIVE SH.P.K., duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka paraqitur Njoftimin për kontratë, për aktivitetin Sigurimi Fizik i objekteve të KPSH-së me numër të prokurimit 622-26-4204-2-1-1.

Autoriteti Kontraktues ka zbatuar procedurën e hapur, me lloj të kontratës shërbime, ndërsa vlera e parashikuar e kontratës është 680,000.00 €.

Me 14.08.2026 KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT duke vepruar në cilësinë e Autoritetit Kontraktues, ka publikuar Njoftimin mbi anulimin (B10).

Me 19.08.2026, OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim ku ska marr pergjigje.

Me 25.08.2026, OE SKYFTERAT - LIVE SH.P.K., ka parashtruar ankesë në OSHP, e cila është evidentuar me numër protokolli 2026/0640, duke e atakuar Vendimin e cituar si më sipër të AK, për anulim.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Organi Shqyrtues i Prokurimit ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues SKYFTERAT - LIVE SH.P.K., janë parashtruar si në vijim:

Në mbështetje të nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar, SKYFTERAT-LIVE SH.P.K., në cilësinë e palës së interesuar, konform nenit 4.1.26 të LPP-së, paraqet këtë Ankesë, duke kundërshtuar në tërësi vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulimin e aktivitetit të prokurimit nr. 622-26-4204-2-1-1.

ANKESË

KRONOLOGJIA:

Duke kundërshtuar në tërësi anulimin e aktivitetit të prokurimit, për shkak se konsiderojmë se arsyeja e përdorur për anulim nuk është demonstruar në përputhje me kërkesat e legjislacionit të prokurimit publik dhe nuk përmbush kushtet ligjore për ndërprerjen e procedurës para hapjes së ofertave.

Me datën 17.08.2026 është publikuar Formulari B10 – Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, nga ana e Autoritetit Kontraktues (Kuvendi Komunal i Prizrenit). Për t'u publikuar ky njoftim, Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së dhe Rregullores Nr. 001/2022, duke anashkaluar procedurat tjera para se të bënte publikimin e këtij Njoftimi B10.

Sipas nenit 21.4, pika (f), të Rregullores Nr. 001/2022 thuhet: Autoriteti Kontraktues duhet të publikojë Njoftimin mbi Vendimin e AK (B58) edhe në rast se vendimi ka të bëjë me anulimin e aktivitetit të prokurimit në tërësi ose një/disa Lot e në kuadër të aktivitetit të prokurimit.

Po ashtu, sipas nenit 43.1 të Rregullores Nr. 001/2022 thuhet: Në rast të vendimit të anulimit të procedurës së prokurimit, AK menjëherë do të përgatisë dhe do të publikojë Formularin B58

“Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues”, ku paraqiten arsyet faktike dhe baza ligjore e anulimit të tillë.

Gjithashtu, tek neni 43.2 i Rregullores Nr. 001/2022 thuhet: Pas skadimit të afatit kohor për parashtrim dhe shqyrtim të ankesave, do të përgatitet-publikohet Njoftimi për Anulim të aktivitetit të prokurimit dhe njoftimin e tillë do ta publikojë në platformën e prokurimit elektronik.

Pra, në platformën e e-Prokurimit, tek aktiviteti i prokurimit me të dhënat: “Sigurimi Fizik i objekteve të KPSH-së”, me nr. të prokurimit: 622-26-4204-2-1-1, shihet qartazi se nuk ekziston asnjë publikim i njoftimit mbi vendimin e AK-së.

Provë:
Imazhi i nxjerrë nga aktiviteti i prokurimit në platformën e e-Prokurimit.

Duke pasur parasysh se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore, ne kemi vepruar sipas rregullave dhe dispozitave ligjore të Prokurimit Publik.

Kompania jonë ka vepruar konform nenit 60.1, pika (c), të Rregullores Nr. 001/2022, ku thuhet: Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin e AK për anulimin e procedurës së prokurimit, brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) për anulim të procedurës së prokurimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimin e AK është dita (0).

Meqenëse nuk kemi pasur Njoftim mbi vendimin e AK (B58), por kemi pasur direkt anulim pa i përfillur procedurat tjera, pra kemi vetëm Njoftimin B10 për anulimin e aktivitetit të prokurimit, i cili është publikuar me datën 17.08.2026, atëherë kompania jonë, me datën 19.08.2026, nëpërmjet platformës së e-Prokurimit, kemi dorëzuar kërkesën për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues (Kuvendi Komunal i Prizrenit).

Pas dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim nga ana jonë, Autoriteti Kontraktues përsëri nuk ka respektuar dispozitat ligjore. Në nenin 61.1 të Rregullores Nr. 001/2022 thuhet: Parashtrimi i kërkesës për rishqyrtim automatikisht pezullon procedurën e prokurimit dhe, në këtë rast, Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, duhet të njoftojë me shkrim të gjitha palët lidhur me pezullimin e procedurës së prokurimit në fjalë.

Pasi që nuk ishte pezulluar procedura e prokurimit, përkundër se kemi paraqitur kërkesën për rishqyrtim, ne kemi pritur që Autoriteti Kontraktues të nxjerrë një vendim në lidhje me kërkesën tonë të dorëzuar, qoftë refuzim apo miratim të saj.

Sipas nenit 63.2 të Rregullores Nr. 001/2022 thuhet: Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik si “Dokument shtesë” tek dosja e tenderit nga Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit.

Në rastet kur Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit nuk nxjerr vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejtë që të parashtrojë një ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) ditë pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. Në kalkulim të afateve kohore, data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0).

Andaj, meqenëse nuk kemi pranuar asnjë përgjigje nga ana e Autoritetit Kontraktues (Kuvendi Komunal i Prizrenit), as edhe një vendim refuzim/miratim dhe as ndonjë kërkesë shtesë për zgjatjen e afatit shtesë, atëherë jemi obliguar që të veprojmë në përputhje me dispozitat ligjore sipas nenit 109 të LPP-së dhe nenit 64.1 të Rregullores Nr. 001/2022.

Konsiderojmë se anulimi është bërë pa u demonstruar ekzistimi i kushteve ligjore që lejojnë ndërprerjen e aktivitetit para hapjes së ofertave, ndërsa arsyetimi i paraqitur nga AK nuk përmbush standardin e kërkuar nga neni 43.1 dhe neni 43.8(a) i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Në veçanti, një deklarim i përgjithshëm se mjetet buxhetore janë marrë nga përmbaruesi nuk është i mjaftueshëm për të provuar se ka ndodhur një ngjarje objektive, e demonstrueshme, jashtë kontrollit të AK-së dhe e paparashikueshme në momentin e inicimit të procedurës.

I. VENDIMI DHE ARSYETIMI I KUNDËRSHTUAR

Në Njoftimin për Anulim, AK ka përzgjedhur si arsye:

"Ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është i nevojshëm për shkak të ngjarjeve dhe/apo arsyeve objektive dhe të demonstrueshme, të cilat janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe të cilat kanë qenë të paparashikueshme në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit."

Ndërsa, në pjesën "Informacionet shtesë", AK e arsyeton anulimin me: "mungesën e mjeteve buxhetore në kategorinë e mallrave dhe shërbimeve si shkak i marrjes së mjeteve buxhetore nga ana e përmbaruesit", duke iu referuar gjithashtu "trendit të marrjes së mjeteve buxhetore nga ana e përmbaruesit" dhe duke konkluduar se realizimi i projektit do të ishte i pamundur edhe për vitet në vijim.

Pikërisht ky arsyetim konsiderojmë se nuk përmbush kriteret ligjore për anulim.

Provë:
Arsyetimi i përdorur tek Njoftimi B10 – për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Dokumentet-Vendimet e Kryetarit të Komunës në lidhje me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi fizik i objekteve shëndetësore të KPSH-së".

Vendimi i parë i lëshuar me datën 26.03.2026, i cili është anuluar më pastaj dhe është lëshuar Vendimi i dytë i datës 21.05.2026, pas ndryshimit të vlerës së parashikuar të kontratës nga 270,000.00 EUR në vlerën e re, sipas vendimit të fundit, në 680,000.00 EUR.

II. SHKELJA E NENIT 9 TË LPP-SË – DISPONUESHMËRIA E FONDEVE PARA INICIMIT

Neni 9 i LPP-së vendos detyrime konkrete për Autoritetin Kontraktues para inicimit të një aktiviteti të prokurimit, lidhur me vlerësimin e nevojave dhe disponueshmërinë e fondeve.

Aktiviteti konkret është iniciuar dhe Njoftimi për Kontratë është publikuar më 04.06.2026. Rrjedhimisht, AK, para inicimit, është dashur të kryejë procedurat e përcaktimit të nevojave dhe disponueshmërisë së fondeve dhe të ketë bazën përkatëse financiare për inicimin e aktivitetit.

Ky fakt krijon një çështje themelore: Nëse fondet kanë ekzistuar dhe janë konfirmuar në momentin e inicimit, AK duhet të dëshmojë se çfarë ngjarjeje konkrete ka ndodhur pas inicimit,

në cilën datë, në çfarë shume dhe pse ajo ngjarje nuk ka mundur të parashikohej më 04.06.2026.

Pa këtë demonstrim, anulimi nuk mund të mbështetet vetëm në një deklarim të përgjithshëm për mungesë fondesh.

Në vijim kemi bashkangjitur dëshmitë "Deklaratën e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve", e miratuar me datën 25.05.2026, e nënshkruar nga personat e autorizuar ZKF dhe e konfirmuar nga ZKA (Kryetari i Komunës) me datën 26.05.2026.

Provë:
Dokumentet e bashkangjitura DNPDF e datës 25.05.2026.

Dëshmi shtesë lidhur me procedurën në fjalë.

III. RREGULLA FINANCIARE NR. 01/2013/MF – ZOTIMI I FONDEVE PARA PROKURIMIT

Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF për Shpenzimin e Parave Publike është veçanërisht relevante.

Sipas nenit 4, procesi i shpenzimit të parasë publike përmban elementet: ndarja buxhetore – alokimi – zotimi – prokurimi – obligimi – pagesa.

Neni 7 përcakton se ndarjet buxhetore regjistrohen në SIMFK dhe sistemi përmban kontrolle të brendshme që shpenzimet të mos realizohen nëse nuk ekzistojnë fonde të mjaftueshme.

Edhe më i rëndësishëm është neni 12.

Sipas nenit 12.1:

"Zotimi është njohje kontabël në SIMFK" e një shpenzimi të mundshëm të ardhshëm të parasë publike.

Ndërsa neni 12.2, duke iu referuar nenit 36.1 të LMFPP-së, kërkon që para inicimit të procesit të prokurimit, organizata buxhetore t'i regjistrojë zotimet e fondeve të ndara në SIMFK.

Rregulla Financiare gjithashtu përcakton se moduli i blerjeve në SIMFK përdoret për regjistrimin e zotimeve dhe obligimeve për shpenzimet që kërkojnë prokurim dhe se zotimi njihet kur procedohet kërkesa për blerje.

Kjo e bën të domosdoshme që AK të paraqesë gjendjen reale të SIMFK-së, jo vetëm një deklarim të përgjithshëm për mungesë mjetesh.

IV. NENI 43.8(a) – KUSHTET PËR ANULIM PARA HAPJES SË OFERTAVE

Neni 43.8(a) i Rregullores Nr. 001/2022 përcakton se procedura para hapjes së ofertave mund të anulohet për shkak të ngjarjeve të demonstrueshme dhe/ose arsyeve jashtë kontrollit të AK-së, të cilat nuk kanë qenë të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit.

Gjithashtu, anulimi sipas kësaj dispozite duhet të bëhet së paku tre ditë para hapjes së tenderëve.

Pra, dispozita vendos disa kushte që duhet të provohen në rastin konkret:

1. duhet të ekzistojë një ngjarje/arsye konkrete;
2. ajo duhet të jetë e demonstrueshme;
3. duhet të jetë jashtë kontrollit të AK-së;
4. nuk duhet të ketë qenë e parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës;
5. duhet të ekzistojë lidhja konkrete ndërmjet kësaj ngjarjeje dhe nevojës për anulimin e procedurës.

Në Njoftimin për Anulim nuk është demonstruar plotësimi i këtyre kushteve.

V. "TRENDI I PËRMBARIMEVE" KUNDËRSHTON PRETENDIMIN PËR PAPARASHIKUESHMËRI

Vetë AK deklaron se ekziston një:

"trend i marrjes së mjeteve buxhetore nga ana e përmbaruesit".

Ky formulim është në kundërthënie serioze me bazën e zgjedhur për anulim.

Nëse kemi të bëjmë me një trend, atëherë bëhet fjalë për një dukuri që nuk paraqitet për herë të parë në mënyrë krejtësisht të papritur.

Prandaj, AK duhet të dëshmojë:

- kur ka filluar ky "trend";
- cilat përmbarime kanë ekzistuar para 04.06.2026;
- kur është njoftuar Komuna për detyrimin konkret;
- kur ka marrë formë të prerë titulli përmbarimor;
- kur është iniciuar procedura përmbarimore;
- dhe kur janë marrë konkretisht mjetet.

Nëse AK ka qenë në dijeni për detyrimin ose për rrezikun real të ekzekutimit para inicimit të aktivitetit, atëherë kushti i paparashikueshmërisë nuk mund të konsiderohet automatikisht i përmbushur.

VI. LMFPP – PËRMBARIMI NUK E KRIJON AUTOMATIKISHT DETYRIMIN PËR ANULIM

Ligji Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë përmban dispozita të posaçme për ekzekutimin e vendimeve të formës së prerë kundër autoriteteve publike.

Neni 40 përcakton mekanizmin përmes të cilit realizohen këto pagesa.

Fakti që ekziston një detyrim përmbarimor nuk do të thotë automatikisht se çdo aktivitet tjetër i prokurimit i organizatës buxhetore duhet të anulohet.

Duhet të demonstrohet se përmbarimi konkret ka prekur realisht fondet e aktivitetit dhe se, pas këtij ekzekutimi, nuk ekziston një mundësi ligjore dhe financiare për vazhdimin e aktivitetit.

Në veçanti, duhet të shqyrtohen mekanizmat e paraparë nga neni 40 i LMFPP-së për rastet kur ndarjet buxhetore në dispozicion nuk janë të mjaftueshme për ekzekutimin e menjëhershëm të tërë detyrimit.

Rrjedhimisht, përmbarimi dhe anulimi i tenderit janë dy çështje juridike të ndryshme. Ligjshmëria e përmbarimit nuk e prodhon automatikisht ligjshmërinë e anulimit.

VII. UDHËZIMI ADMINISTRATIV NR. 08/2009 DHE LIGJI PËR PROCEDURËN PËRMBARIMORE

Edhe Udhëzimi Administrativ Nr. 08/2009 për Ekzekutimin dhe Pagesën e Vendimeve Përmbaruese të Gjykatave dhe Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore duhet të interpretohen në harmoni me LMFPP-në.

Këto dispozita rregullojnë mënyrën e realizimit të detyrimeve përmbarimore. Ato nuk krijojnë vetvetiu një bazë të re për anulimin e aktiviteteve të prokurimit publik.

Për anulim, AK vazhdon të jetë i detyruar t'i plotësojë kushtet specifike të LPP-së dhe nenit 43 të Rregullores Nr. 001/2022.

Prandaj, AK duhet të identifikojë:

- titullin konkret përmbarimor;
- numrin e lëndës;
- kreditorin;
- shumën;
- datën e ekzekutimit;
- mënyrën e ekzekutimit;
- ndarjen buxhetore të prekur;
- dhe ndikimin konkret në zotimin e aktivitetit nr. 622-26-4204-2-1-1.

VIII. SHKELJA E NENIT 43.1 – MUNGESA E ARSYETIMIT FAKTIK DHE BAZËS LIGJORE

Ky është një nga pretendimet kryesore të kësaj Ankese.

Neni 43.1 i Rregullores Nr. 001/2022 përcakton se, në rast të vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit, AK duhet menjëherë të përgatisë dhe publikojë Formularin B58 – "Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", ku duhet të paraqiten arsyet faktike dhe baza ligjore e anulimit.

Kjo dispozitë nuk është vetëm kërkesë formale.

Qëllimi i saj është që pala e interesuar të mund ta kuptojë saktësisht:

Çfarë ka ndodhur?
Kur ka ndodhur?
Cili fakt e ka shkaktuar anulimin?
Cila provë e vërteton atë fakt?
Dhe mbi cilën dispozitë ligjore konkrete mbështetet anulimi?

Në rastin konkret, një deklarim i përgjithshëm se: "përmbaruesi ka marrë mjetet" nuk e zëvendëson demonstrimin faktik që kërkon neni 43.1, e aq më pak provon kushtet materiale të nenit 43.8(a).

Njoftimi për Anulim nuk identifikon së paku:

- shumën e mjeteve të marra;
- datën e marrjes së tyre;
- titullin përmbarimor;
- numrin e lëndës përmbarimore;
- datën kur AK ka marrë dijeni për detyrimin;
- kodin buxhetor nga i cili janë ekzekutuar;
- shumën që ka ekzistuar para përmbarimit;
- shumën e mbetur pas përmbarimit;
- zotimin konkret të këtij aktiviteti;
- ndikimin konkret të përmbarimit në këtë zotim;
- analizën financiare që demonstron pamundësinë e vazhdimit;
- bazën juridike që lidh përmbarimin konkret me domosdoshmërinë e anulimit të aktivitetit.

Përkundrazi, në B10 është dhënë vetëm një konstatim i përgjithshëm për mungesën e mjeteve në kategorinë mallra dhe shërbime dhe "trendin" e përmbarimeve.

Kjo nuk është e njëjtë me paraqitjen e arsyeve faktike dhe bazës ligjore, siç kërkon shprehimisht neni 43.1.

Për këtë arsye, konsiderojmë se vendimi është i mangët edhe në aspektin e arsyetimit dhe transparencës së vendimmarrje

IX. DUHET TË VERIFIKOHET RESPEKTIMI I PROCEDURËS B58 → B10

Përveç përmbajtjes së vendimit, duhet të verifikohet edhe procedura që AK ka ndjekur për anulimin.

Sipas nenit 43.1, në rast të vendimit për anulim, AK duhet menjëherë të përgatisë dhe publikojë Formularin B58 – Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, ku paraqiten arsyet faktike dhe baza ligjore e anulimit.

Ndërsa, procedura e nenit 43 duhet të respektohet në tërësi para finalizimit të anulimit dhe publikimit të B10.

Dokumenti që kemi në dispozicion është B10 – Njoftimi për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit, i përgatitur më 14.08.2026.

Për këtë arsye kërkojmë që AK të verifikojë dhe të dëshmojë:

1. datën e marrjes së vendimit për anulim;
2. datën e publikimit të B58;
3. përmbajtjen e plotë të B58;
4. arsyet faktike të paraqitura në B58;
5. bazën ligjore të paraqitur në B58;
6. respektimin e afatit për ushtrimin e mjeteve juridike;
7. datën e përgatitjes dhe publikimit të B10;
8. respektimin e rendit procedural të kërkuar nga neni 43.

Nëse B58 nuk është publikuar, ose nëse B58 nuk përmban arsyet faktike dhe bazën ligjore të kërkuar nga neni 43.1, atëherë kemi një mangësi procedurale që duhet të shqyrtohet veçmas nga vetë arsyeja materiale e anulimit.

X. AK DUHET TË DËSHMOJË NËSE JANË PREKUR FONDET E KËTIJ AKTIVITETI

Njoftimi për Anulim nuk deklaron se përmbaruesi ka marrë pikërisht fondet e zotuara për aktivitetin nr. 622-26-4204-2-1-1.

Ai thotë vetëm se ekziston mungesë e mjeteve në "kategorinë e mallrave dhe shërbimeve".

Ky dallim është thelbësor.

Zvogëlimi i përgjithshëm i një kategorie buxhetore nuk provon automatikisht pamundësinë e financimit të këtij aktiviteti specifik.

AK duhet të dëshmojë lidhjen:

fondet e aktivitetit → zotimi në SIMFK → përmbarimi → zvogëlimi/anulimi i zotimit → pamundësia reale e financimit.

Pa këtë lidhje dokumentare, nuk mund të konsiderohet e provuar domosdoshmëria e anulimit.

XI. PRETENDIMI PËR PAMUNDËSI "PËR VITET NË VIJIM" ËSHTË I PADEMONSTRUAR

AK deklaron se:

"realizimi i këtij projekti do të ishte i pamundur për vitet në vijim bazuar në kapacitetet buxhetore që ka drejtoria."

Ky është një konkluzion për të ardhmen.

Por, në Njoftimin për Anulim nuk është paraqitur:

- analizë financiare shumëvjeçare;
- projeksion i buxhetit;
- ndarje buxhetore për vitet përkatëse;
- detyrime të pritshme përmbarimore;
- plan i rrjedhës së parasë;
- apo dokument tjetër që demonstron këtë pamundësi.

Termi "konsiderojmë" nuk e zëvendëson standardin "të demonstrueshme" të nenit 43.8(a).

XII. EKZISTENCA E MEKANIZMAVE PËR MENAXHIMIN E FONDEVE

Rregulla Financiare Nr. 01/2013/MF parashikon mekanizma për menaxhimin e ndarjeve dhe alokimeve.

Neni 8 njeh mundësinë e transferimit të ndarjeve buxhetore ndërmjet programeve dhe kodeve ekonomike sipas rregullave të LMFPP-së.

Neni 10 gjithashtu rregullon alokimin e fondeve dhe parashikon që, nëse organizata buxhetore dëshiron ndryshimin e alokimeve për t'iu përshtatur ndryshimeve në planin e ekzekutimit të buxhetit, kërkesa i drejtohet Drejtorit të Thesarit.

Prandaj, para se mungesa momentale e fondeve të përdoret si bazë për anulim, duhet të demonstrohet situata konkrete financiare dhe pamundësia reale e vazhdimit në kuadër të mekanizmave ligjorë në dispozicion.

XIII. PARIMET E LPP-SË

Vendimmarrja e AK-së duhet të jetë në përputhje jo vetëm me dispozitën teknike për anulim, por edhe me parimet themelore të LPP-së lidhur me:

- ekonomicitetin dhe efikasitetin;
- transparencën;
- trajtimin e barabartë;
- integritetin e procedurës;
- dhe përdorimin e ligjshëm të fondeve publike.

Anulimi është një veprim me pasoja të drejtpërdrejta për konkurrencën dhe operatorët ekonomikë që kanë investuar kohë dhe resurse në përgatitjen për procedurën.

Prandaj, arsyeja e anulimit duhet të jetë reale, konkrete, e provueshme dhe juridikisht e mbështetur.

XIV. KONKLUZION

Nga interpretimi i përbashkët i:

- Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik;
- nenit 9 të LPP-së;
- nenit 62 të LPP-së;
- nenit 108/A të LPP-së;
- nenit 43.1 të Rregullores Nr. 001/2022;
- nenit 43.2 të Rregullores;
- nenit 43.8(a) të Rregullores;
- Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë;
- dispozitave të LMFPP-së mbi zotimet dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore;
- Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore;
- Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2009 për Ekzekutimin dhe Pagesën e Vendimeve Përmbaruese të Gjykatave;
- Rregullës Financiare Nr. 01/2013/MF – Shpenzimi i Parave Publike;
- dhe rregullave për SIMFK, alokimin dhe zotimin e fondeve,

konsiderojmë se arsyetimi i paraqitur nga AK nuk demonstron plotësimin e kushteve ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Në veçanti, AK:

- nuk ka demonstruar ngjarjen konkrete të paparashikueshme;

- nuk ka demonstruar shumën dhe datën e përmbarimit;
- nuk ka demonstruar se janë prekur pikërisht fondet e këtij aktiviteti;
- nuk ka demonstruar gjendjen e zotimit në SIMFK;
- nuk ka demonstruar pamundësinë e financimit të aktivitetit;
- nuk ka demonstruar pamundësinë e realizimit për vitet e ardhshme;

dhe arsyetimi i publikuar nuk paraqet në mënyrë të plotë faktet dhe bazën juridike që kërkon neni 43.1 i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për më tepër, referimi nga vetë AK në një "trend" të përmbarimeve krijon dyshim serioz nëse rrethana e përdorur për anulim mund të konsiderohet njëkohësisht e paparashikueshme në kuptimin e nenit 43.8(a).

Për këto arsye, konsiderojmë se anulimi, mbi bazën dhe arsyetimin konkret të paraqitur nga AK, nuk është juridikisht i qëndrueshëm dhe duhet të anulohet.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 26.08.2026 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 2026/0640, ndërsa me datë 28.08.2026 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2026/0640, me rekomandimet si në vijim: Duke u bazuar në sqarimet dhe vlerësimet e mësipërme, eksperti shqyrtues i propozon Panelit Shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet Njoftimi për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit dhe aktiviteti i prokurimit të rikthehet në fazën para publikimit të Formularit B10.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. AK është pajtuar rekomandimet e raportit të ekspertit shqyrtues, ndërsa OE nuk është pajtuar lidhur me raportin e ekspertit shqyrtues.

Paneli shqyrtues ka vlerësuar se janë plotësuar kushtet për të vendosur mbi këtë lëndë pa seancë dëgjimore në kuptim të nenit 24 paragrafi 1 të Rregullores së Punës së OSHP-së duke marr parasysh që pretendimet e palëve dhe parashtresat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor lidhur me rastin.

- *Administrimi dhe vlerësimi i provave –*

Me qëllim të vërtetimit të drejtë gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova Raportin e Ekspertit Shqyrtues, parashtresat dhe dokumentet e operatorit ekonomik ankues, shkresat dhe dokumentet e Autoritetit Kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Lidhur me pretendimet e OE SKYFTERAT - LIVE SH.P.K.,eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0640 ka vlerësuar si në vijim:

I. PRETENDIMET ANKIMORE

OE ankues SKYFTERAT-LIVE SH.P.K., duke kundërshtuar anulimin e aktivitetit të prokurimit "Sigurimi Fizik i objekteve të KPSH-së", me numër të prokurimit 622-26-4204-2-1-1, pretendon se Autoriteti Kontraktues – Kuvendi Komunal i Prizrenit, nuk ka respektuar kërkesat procedurale të legjislacionit të prokurimit publik dhe se arsyeja e përdorur për anulimin e aktivitetit nuk është demonstruar në mënyrë të mjaftueshme.

Ankuesi pretendon se AK ka publikuar më 17.08.2026 Formularin B10 – "Njoftimin për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit", pa publikuar paraprakisht Formularin B58 – "Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues". Sipas tij, në rast të anulimit, AK është dashur fillimisht të publikojë B58, me arsyet faktike dhe bazën ligjore të anulimit, ndërsa B10 të publikohej vetëm pas respektimit të afatit për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për rishqyrtim. Për këtë arsye, ankuesi pretendon se nuk është respektuar rendi procedural i përcaktuar me nenin 43 të RrPP-së.

Ankuesi deklaron gjithashtu se më 19.08.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim përmes platformës E-Prokurimi, mirëpo, sipas tij, AK nuk e ka pezulluar procedurën dhe nuk ka nxjerrë vendim lidhur me kërkesën për rishqyrtim. Në mungesë të një vendimi të AK-së brenda afatit përkatës, ankuesi deklaron se i është drejtuar OSHP-së.

Në aspektin material, ankuesi kundërshton arsyetimin e AK-së se anulimi ka qenë i nevojshëm për shkak të mungesës së mjeteve buxhetore si rezultat i marrjes së tyre nga përmbaruesi. Sipas tij, një deklarim i përgjithshëm për mungesë fondesh nuk është i mjaftueshëm për të dëshmuar ekzistimin e një ngjarjeje konkrete, të demonstrueshme, jashtë kontrollit të AK-së dhe të paparashikueshme në momentin e inicimit të procedurës, siç kërkohet me nenin 43.8(a) të RrPP-së.

Në këtë drejtim, ankuesi thekson se para inicimit të aktivitetit ka ekzistuar Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së Fondeve, e miratuar më 25.05.2026 dhe e konfirmuar më 26.05.2026, për vlerën e parashikuar prej 680,000.00 euro. Për këtë arsye, sipas tij, AK duhet të dëshmojë se çfarë rrethane financiare ka ndodhur pas inicimit të procedurës, kur ka ndodhur, në çfarë shume dhe pse nuk ka mundur të parashikohej më herët.

Ankuesi i referohet edhe rregullave financiare për zotimin e fondeve, duke pretenduar se AK duhet të paraqesë gjendjen reale të zotimit në SIMFK dhe ndikimin konkret të ekzekutimit përmbarimor në fondet e destinuara për këtë aktivitet. Po ashtu, ai kundërshton referimin e AK-së në një "trend të marrjes së mjeteve buxhetore nga ana e përmbaruesit", duke konsideruar se një formulim i tillë vë në pikëpyetje kushtin e paparashikueshmërisë.

Më tej, ankuesi pretendon se ekzistenca e një detyrimi përmbarimor nuk nënkupton automatikisht se janë plotësuar kushtet për anulimin e aktivitetit. Sipas tij, AK duhet të identifikojë titullin konkret përmbarimor, numrin e lëndës, kreditorin, shumën dhe datën e ekzekutimit, ndarjen buxhetore të prekur dhe ndikimin konkret në zotimin e aktivitetit.

Sipas ankuesit, arsyetimi i AK-së nuk përmbush kërkesat e nenit 43.1 të RrPP-së, pasi nuk janë paraqitur në mënyrë të plotë arsyet faktike dhe baza ligjore e anulimit. Ankuesi pretendon gjithashtu se AK nuk ka dëshmuar se përmbarimi ka prekur pikërisht fondet e këtij aktiviteti dhe se mungesa e mjeteve në kategorinë "mallra dhe shërbime" nuk provon automatikisht pamundësinë e financimit të tij.

Gjithashtu, ankuesi kundërshton konstatimin se realizimi i projektit do të ishte i pamundur edhe për vitet në vijim, duke pretenduar se një përfundim i tillë nuk është mbështetur me analizë financiare apo dokumentacion përkatës.

Po ashtu, ankuesi pretendon se para marrjes së vendimit për anulim, AK është dashur të vlerësojë mundësitë ligjore për menaxhimin e ndarjeve dhe alokimeve buxhetore dhe se mungesa

momentale e mjeteve nuk mund të shërbejë si bazë e mjaftueshme për anulim pa u demonstruar situata konkrete financiare dhe pamundësia reale e vazhdimit të aktivitetit.

Për këto arsye, ankuesi konsideron se AK nuk ka dëshmuar plotësimin e kushteve ligjore për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe kërkon anulimin e vendimit/njoftimit për anulim dhe vazhdimin e aktivitetit nga faza në të cilën është ndërprerë.

II. VLERËSIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës të procedurës, në raport me pretendimet ankimore të OE ankues, eksperti shqyrtues sqaron dhe vlerëson si në vijim:

Nga të dhënat e aktivitetit të prokurimit rezulton se Formulari B10 – "Njoftimi për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit" është dërguar më 17.08.2026, ndërsa afati për dorëzimin dhe hapjen e tenderëve ka qenë më 21.08.2026. Anulimi i aktivitetit është bërë para hapjes së ofertave, fazë në të cilën anulimi rregullohet me nenin 43.8(a) të RrPP-së.

Sipas nenit 43.1 të RrPP-së, në rast të vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit, AK duhet menjëherë të përgatisë dhe publikojë Formularin B58 – "Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues", në të cilin paraqiten arsyet e anulimit. Ndërsa, sipas nenit 43.2 të RrPP-së, pas skadimit të afatit për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për rishqyrtim, procedohet me përgatitjen dhe publikimin e Formularit B10 – "Njoftimi për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit".

Rrjedhimisht, rendi procedural i përcaktuar me këto dispozita është:

B58 → afati për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për rishqyrtim → B10.

Nga analizimi i aktivitetit në platformën E-Prokurimi rezulton se AK nuk ka publikuar Formularin B58, por ka proceduar drejtpërdrejt me Formularin B10 dhe me kalimin e aktivitetit në statusin "Anuluar".

Në këto rrethana, eksperti shqyrtues konstaton se AK nuk ka respektuar rendin procedural të detyrueshëm të përcaktuar me nenin 43.1 dhe 43.2 të RrPP-së. Kjo shkelje nuk mund të trajtohet si mangësi vetëm formale. Formulari B58 është akti përmes të cilit palëve të interesuara u komunikohet vendimi i AK-së, së bashku me arsyet dhe bazën ligjore mbi të cilat mbështetet ai vendim, ndërsa nga publikimi i tij fillon afati për paraqitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për rishqyrtim. Duke anashkaluar këtë fazë dhe duke kaluar drejtpërdrejt në publikimin e Formularit B10, AK ka cenuar rendin procedural të paraparë për njoftimin e palëve dhe ushtrimin e së drejtës për rishqyrtim ndaj vendimit për anulim.

Për rrjedhojë, eksperti shqyrtues vlerëson se pretendimi i OE ankues lidhur me mosrespektimin e procedurës së anulimit është i bazuar.

Sa i përket kërkesës për rishqyrtim, OE ankues deklaron se më 19.08.2026 ka paraqitur kërkesë përmes platformës E-Prokurimi dhe se Autoriteti Kontraktues nuk e ka pezulluar procedurën dhe nuk ka nxjerrë vendim lidhur me të.

Gjatë analizimit të procedurës në platformën E-Prokurimi, dokumenti i kërkesës për rishqyrtim nuk rezulton aktualisht i dukshëm apo i qasshëm, prandaj eksperti shqyrtues nuk ka mundur të verifikojë drejtpërdrejt ekzistencën e saj në platformë, datën dhe përmbajtjen e kërkesës, si dhe

mënyrën e trajtimit të saj nga Autoriteti Kontraktues.

Për këtë çështje, eksperti shqyrtues ka kërkuar sqarim nga KRPP. Sipas përgjigjes së pranuar, kërkesa për rishqyrtim mund të paraqitet edhe pas publikimit të Formularit B10, mirëpo, për të pasur qasje në funksionet përkatëse të platformës E-Prokurimi, aktiviteti duhet të hiqet nga statusi "Anuluar", ndërsa kërkesa për ndryshimin e këtij statusi duhet të iniciohet nga Autoriteti Kontraktues.

Nga ky sqarim rezulton se mungesa e qasjes në dokumentin e kërkesës për rishqyrtim nuk mund të merret, si bazë për të konstatuar se ajo nuk është paraqitur.

Autoritetit Kontraktues i rikujtohet se, në rast se konfirmohet paraqitja e kërkesës për rishqyrtim dhe mungesa e vendimmarrjes lidhur me të, një mosveprim i tillë përbën mosrespektim të rregullave për trajtimin e kërkesave për rishqyrtim. Sipas nenit 97.1, pika (e) të RrPP-së, si shkelje e rëndë konsiderohet: "Mos respektimi i rregullave për trajtimin e kërkesave për rishqyrtim pranë Autoritetit Kontraktues."

Sa i përket arsyeve materiale të anulimit, nga dokumentacioni rezulton se AK është mbështetur në mungesën e mjeteve buxhetore si pasojë e përmbarimit. Eksperti shqyrtues vlerëson se mungesa reale e mjeteve buxhetore mund ta bëjë të pamundur marrjen e obligimeve kontraktuale nga Autoriteti Kontraktues, megjithatë, kjo rrethanë duhet të dëshmohet me fakte, dokumentacion financiar dhe arsyetim konkret që demonstron ndikimin e saj në këtë aktivitet të prokurimit, në mënyrë që të vlerësohet nëse janë përmbushur kushtet e nenit 43.8(a) të RrPP-së. Arsyet dhe dëshmitë përkatëse duhet të pasqyrohen në mënyrë të qartë dhe, në pajtim me nenin 43.1 të RrPP-së.

III. PËRFUNDIMI

Mbështetur në arsyetimin e mësipërm, eksperti shqyrtues vlerëson se ankesa e OE ankues është e bazuar, pasi gjatë shqyrtimit janë evidentuar shkelje të dispozitave të legjislacionit të prokurimit publik, përkatësisht mosrespektimi nga Autoriteti Kontraktues i rendit juridik dhe procedural të përcaktuar me nenin 43.1 dhe 43.2 të RrPP-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Për rrjedhojë, rekomandohet që aktiviteti i prokurimit të rikthehet në fazën para publikimit të Formularit B10, me qëllim të korrigjimit të shkeljeve të konstatuara dhe vazhdimit të procedurës në pajtim me legjislacionin në fuqi.

Autoritetit Kontraktues i rikujtohet gjithashtu se, në rast të konfirmimit të paraqitjes së kërkesës për rishqyrtim dhe mosnxjerrjes së vendimit përkatës, kjo çështje duhet të vlerësohet edhe në raport me nenin 97.1, pika (e) të RrPP-së, i cili mosrespektimin e rregullave për trajtimin e kërkesave për rishqyrtim e klasifikon si shkelje të rëndë.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në ketë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore. Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për

Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjera, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar. Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së.

Paneli Shqyrtues në këtë ankesë nuk mund ta mbështet rekomandimin e ekspertit shqyrtues , ndërsa ankesa e OE ankues të aprovohet si pjesërisht e bazuar, për faktin se Autoriteti kontraktues me dt.14.08.2026, ka publikuar ne e-prokurim Formularin B10 – "Njoftimin për Anulimin e Aktivitetit të Prokurimit", ndërsa ne arsyetim ka theksuar mungesën e mjeteve financiare per shkak te detyrimeve financiare te cilat janë tërhequr nga ana e përmbaruesve privat. AK ne këtë rast nuk i ka hapur fare ofertat duke e ditur se nuk ka mjete financiare dhe e ka anuluar aktivitetin e prokurimit. Vlerësoj se problematika te ngjashme e marrjen e mjeteve financiare nga përmbaruesit kane pasur dhe komunat tjera, andaj e mbështesë vendimin e AK, per anulimin e aktivitetit te prokurimit, poashtu anulimi i këtij aktiviteti është bërë para hapjes se ofertave dhe se sipas nenit 24 të LPP-se citohet 2. Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj. 3. Zyrtari i Prokurimit i një autoriteti kontraktues është përgjegjës që menjëherë t'i raportojë KRPP-së mbi aktivitetet e prokurimit të autoritetit përkatës kontraktues që ekzekutohen në një mënyrë që nuk është në pajtim me këtë ligj.

Paneli Shqyrtues konstaton se nuk mund të detyrohet Autoriteti Kontraktues të hyjë në obligime financiare, pasi kjo përbën shkelje në munges të alokimeve buxhetore dhe me Ligjin përmenaxhimine financave publike . andaj veprimi i Autoritetit Kontraktues është plotësisht i bazuar në rregullat e menaxhimit të financave publike siaps arsyetimit ku mjetet e dedikuara jane tërhejkur nga përmbaruesi.

Rjedhimishte, Paneli Shqyrtues mbështetur në nenin 1 dhe 7 të LPP-se ka vendos ta lë në fuqi B10 Njoftimi per anulimin e aktivitetit te prokurimit lidhur me aktivitetin me titull ''Sigurimi Fizik i objekteve të KPSH-së me numër të prokurimit 622-26-4204-2-1-1''.

Mirpo PSH i bënë me dije AK-se se do ta monitoron këtë procedur e ne raste te ritenderimit pa u alokuar mjetet , apo aplikimin e nenit 35 të LPP-se duke zhvilluar procedur të negociuar pa publikim për të njëjtin aktivitet do të mare masa konform dispozitave ligjire të LPP-se, dhe Rregullores per Punes së OSHP-se.

Paneli vlerësues sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit

të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës...” si dhe në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nënpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP-së, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Andaj, duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Batisha Ibrahimi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi mund t'i drejtohet Gjykatës Administrative në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm për anulim të vendimit në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **KUVENDI KOMUNAL I PRIZRENIT**
- OE - **SKYFTERAT - LIVE SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: